

REZOLUTË
Nr.1, datë 4.3.1998

PËR EMIGRACIONIN

Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë, duke ndjekur me preokupim të veçantë fatin e emigrantëve shqiptarë, që jetojnë e punojnë në vende të ndryshme të Europës e gjetkë,

vëren me keqardhje se kanë emigruar, sipas të dhënave të përafërta, rreth 500 mijë shtetas shqiptarë, kryesisht të rinj, që përbëjnë pjesën më vitale të popullsisë, se nga gjithë kjo masë e madhe emigrantësh, kanë arritur të integrohen në vendet ku jetojnë dhe të sigurojnë punë e strehim një pjesë shumë e vogël e tyre.

I shqetësuar nga kjo hemorragji e madhe kombëtare, Kuvendi Popullor konfirmon faktin se Qeveria Shqiptare gjatë periudhës së kaluar asnjëherë nuk e ka trajtuar këtë problem me seriozitetin që meriton, gjë që ka çuar në lënien e tyre në mëshirë të fatit. Shtetasit shqiptarë janë ndier të braktisur të harruar e pothuaj të mohuar nga shteti i tyre, sepse institucionet e tij jo vetëm që nuk arritën ta përballojnë këtë problem të madh ose të paktën ta fusnin në rrugën e zgjidhjes, por në disa raste, me qëndrime të papërgjegjshme, që buronin nga klientelizmi politik, kanë cenuar drejtpërdrejt interesat e tyre.

Prandaj Kuvendi Popullor angazhohet tërësisht të gjejë rrugët dhe mundësitë për zgjidhjen e problemeve që janë të detyruar të përballojnë emigrantët shqiptarë.

Për këtë qëllim:

Kërkon nga Komisioni i Përhershëm i Ligjeve, Komisioni i Përhershëm i Punës dhe Përkrahjes Sociale, Komisioni i Përhershëm i të Drejtave të Njeriut, si dhe Komisioni i Përhershëm i Rendit dhe i SHIK-ut rishikimin e gjithë legjislacionit që ka të bëjë me këtë problem, si dhe plotësimin e tij për të krijuar një kuadër të nevojshëm ligjor sa më të plotë;

kërkon nga Qeveria Shqiptare që brenda 31 marsit të hartojë dhe të shpallë publikisht një program të detajuar për njohjen e gjendjes reale të emigrantëve, duke filluar nga saktësimi i numrit, përcaktimi i vendndodhjes, evidentimi i kushteve në të cilat jetojnë e punojnë dhe të marrë përsipër detyrimet e shtetit shqiptar për t'u dalë zot shtetasve të vet, duke kërkuar nga shtetet përkatëse konfirmimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre themelore konform akteve ndërkombëtare. Në këtë kuadër, Qeveria dhe dikasteret e specializuara të arrijnë që në bashkëpunim me qeveritë e vendeve përkatëse, të saktësojë numrin e emigrantëve të vrarë, të vdekur e të gjymtuar dhe të vendosen procedura të sakta për ndërhyrjen e shtetit shqiptar në raste të tilla, si dhe të kërkojë nisjen e hetimit individual për çdo shtetas shqiptar të vrarë, të zhdukur dhe të aksidentuar për zhdëmtimin e viktimave konform ligjeve e parimeve ndërkombëtare.

Kuvendi Popullor kërkon nga Qeveria Shqiptare të saktësojë numrin e emigrantëve që vuajnë dënimet në shtetet ku gjenden dhe të gjejë zgjidhje ligjore për t'iu siguruar atyre të gjitha të drejtat që u takojnë sipas ligjeve në fuqi në shtetin përkatës.

Kuvendi Popullor kërkon nga Qeveria ndjekjen me përparësi të hetimeve dhe gjykimit të drejtë e me transparencë të plotë të incidentit tragjik të Otrantos dhe shpërblimin e familjeve të viktimave sipas normave ndërkombëtare.

Kuvendi Popullor përshëndet hapat e nisur nga Qeveria për legalizimin e emigrantëve, sigurimin e kushteve për një emigracion legal dhe punësimin e përkohshëm të kontrolluar nga shteti. Kuvendi përshëndet, gjithashtu, parlamentet dhe qeveritë e vendeve mike Greqi e Itali, ku ndodhet përqendrimi më i madh i emigrantëve, për mirëkuptimin dhe përkrahjen në trajtimin e problemit të rëndë të emigracionit tonë. Në të njëjtën kohë Kuvendi kërkon marrjen e masave për bllokimin përfundimtar të emigracionit klandestin, që shpeshherë shndërrohet në tragjedi të rënda njerëzore. Në këtë vështrim, të shpejtohet hapja e konsullatave. Në marrëveshjet për legalizimin e emigrantëve të parashihet plotësimi i kushteve për sigurimin e jetës së tyre e të shkollimit në klube e shoqata për ruajtjen e identitetit dhe të vlerave kulturore e atdhetare.

Kuvendi Popullor i propozon Qeverisë ngritjen e një institucioni, për të siguruar

koordinimin ndërdikasterial, që të marrë mbi vete përgjegjësitë e zgjidhjes së problemeve të emigracionit, pa lënë mënjane këtu edhe emigracionin e vjetër, integrimi i të cilit në jetën shqiptare ka qenë formal e shpeshherë spekulativ.

Kuvendi Popullor shpreh bindjen se angazhimi i shtetit shqiptar për zgjidhjen e problemit të emigrantëve shqiptarë, që jetojnë e punojnë në vende të tjera, do të jetë tërësor dhe do të çojë në trajtimin e tyre si qytetarë e të lirë e të barabartë me të gjithë qytetarët e tjerë të shteteve përkatëse.